



REPUBLIKA E SHQIPERISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 95, Datë 04.07.2017

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E
VENDOSJES SË GJOBAVE DHE MASËN KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE NË
SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16, 106/2 të Ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e Gazit Natyror"; Ligjit Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative"; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës mbi miratimin e draft-rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror,

Konstatohet se:

- Entin Rregullator në mbështetje të nenit 106/2, të Ligjit 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", miraton Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror.
- Me Vendimin me nr. 170, datë 31.10.2016, ERE filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft "Rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror".
- ERE me shkresën nr. 722 prot., datë 02.11.2016, dërgoi draft – "Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror", për marrje mendimi, pranë subjekteve MEI, Autoritetit i Konkurrencës, Albpetrol, Phoenix Petroleum dhe ANIO Oil & Gas sh.a.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 369/1, datë 30.11.2016 është shprehur se draft – "Rregullorja për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror", nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës."
- MEI me shkresën nr. 6596/1 Prot., datë 29.12.2016, ka përcjellë në ERE dakortësinë e saj lidhur me draft – "Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror".

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me korrespondencën elektronike datë 09.03.2017 protokolluar me tonën me nr. 220 prot, datë 10.03.2017, ka përcjellë në ERE komentet mbi draft – “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/RREG_E_GJOBAVE_NE_SEKTORIN_E_GAZIT_NATYROR.pdf

RREGULLORE

MBI KUSHTET DHE PROCEDURAT E VENDOSJES SË GJOBAVE DHE MASËN KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE.

Pjesa e Parë

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 106/2 te Ligjit nr.102/2015 “Per Sektorin e Gazit Natyror” Ligjit 45/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” Ligji Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "per kundravajtjet administrative". dhe në përputhje me “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e Gazit Natyror, për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të Ligjit nr.102/2015 “Per Sektorin e Gazit Natyror”. ERE aplikon procedura të njëjta për të licencuarit në sektorin e gazit natyror në rastet e vendosjes së gjobave.

Neni 3

Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat e aplikimit të gjobave, metodologjinë e konstatimit e përcaktimit të tyre, si dhe masat e lehtësimit që aplikohen për gjobat e vendosura për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në rastet e shkeljeve të ndërshkueshme me gjobë nga ERE.

Neni 4

Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- 1. Ligj-** do të thotë Ligji nr.102/2015 “Per Sektorin e Gazit Natyror”
- 2. Bordi i ERE-** do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.
- 3. ERE-** do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.
- 4. Licensë-** do të thotë një e drejte e dhënë nga ERE-ja, një personi për ushtrimin e nje veprimtarie ne sektorin e gazit natyror ne perputhje me dispozitat qe kerkohen nga Ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe procedurave të licensimit të ERE-s
- 5. I licensuar-** do të thotë një person i pajisur me një licensë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e Gazit Natyror.

6. **Procedurë** - Do të thotë tërësi e veprimeve të ERE-s, për marrjen e masave administrative të vendosjes dhe reduktimit të gjobave, për të licensuarit në Sektorin e Gazit Natyror.
7. **Subjekt i interesuar**- do të thotë çdo i licensuar apo çdo person tjetër që merr shërbim apo kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.
8. **Të ardhurat vjetore**- do të thotë totali i të ardhurave të gjeneruara nga shitja e të mirave të sigurara nga aktiviteti në sektorin e gazit natyror apo shërbimeve të kryera gjatë një viti financiar nga një subjekt tregtar.
9. **Xhiro mesatare ditore**- do të thotë të ardhurat mesatare të sigurura në ditë nga shitja dhe/ose ofrimi i shërbimeve në sektorin e gazit natyror.
10. **Vlera fillestare e gjobës**- do të quhet vlera e përcaktuar nga Bordi i ERE për efekt të llogaritjes së vlerës përfundimtare të gjobës e cila llogaritet sipas Aneksit nr. 1 bashkëngjitur kësaj Rregullore.
11. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimin e parashikuar në ligjin 102/2015 “ Për Sektorin e gazit Natyror

PJESA E DYTË DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 5 Gjobat

1. Çdo i licensuar mund të jetë subjekt i ndëshkimit nga ERE për një ose më shume nga shkeljet e kryera prej tij, si më poshtë:
 - a) dënohen nga ERE me gjobë nga 0,1 % deri në 0,5 % të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të të licensuarit shkeljet e kryera nga subjektet e licensuara:
 - i. kryerja e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror pa licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 22, të Ligjit.
 - ii. veprimet e kryera nga subjektet që i nënshtrohen zbatimit të Ligjit, të realizuara në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencë, sipas parashikimeve të neneve 50, pika 4, 75, 85, pika 4, si dhe veprimet në kundërshtim me shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, të pikës 1, të nenit 41, të Ligjit;
 - iii. refuzimi i paraqitjes së të dhënave, informacioneve, raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licensuari, në kundërshtim me nenet 17, pika 1/a, 37, pika 6, 39, pika 2, 40, pika 2, 53, pikat 5 e 6, 63, pika 6, 66, 73, 87, pika 4, 92, pika 3, 95, pika 5, dhe 97, pikat 1, 2, 5, 7 e 9, të Ligjit;
 - iv. moszbatimi i detyrimeve, lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave, sikurse kërkohet në nenet 17, pika 1, shkronja “dh”, 33, pikat 1-7, 90, pikat 10 e 11, dhe 56, pika 4, të Ligjit;
 - v. moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas kërkesave të neneve 92, pika 11, dhe 93, pikat 2 e 4, të Ligjit;

- vi. moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 30, 75, 80, pika 6, dhe 85, pika 6, të Ligjit;
 - vii. moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në nenet 42, pikat 1-3, 54, 64 dhe 71, të Ligjit;
 - viii. moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara si dhe vendosja e kushteve shtesë në kontratën e furnizimit apo mosnjoftimi, në kundërshtim me nenet 76, pika 5, dhe 90, pika 4, të Ligjit;
 - ix. mospublikimi i informacionit për tarifat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimi i shërbimeve të rrjetit, sikurse përcaktohet në nenin 33, pika 8, të Ligjit;
 - x. mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 46 dhe 56, të Ligjit, si dhe rregullores përkatëse të ERE-s.
 - xi. shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE, parashikuar në nenin 89, pika 4, të Ligjit;
 - xii. moszbatimi i vendimeve të ERE-s;
 - xiii. mosrespektimi i kërkesave të neneve 39, pikat 4 e 6, dhe 60, shkronja “ç”, të Ligjit;
 - xiv. mosmarrja e masave për hartimin e programit të përputhshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë, sipas kërkesave të neneve 47, pika 1, 51, pika 5, dhe 80, pika 7, të Ligjit;
 - xv. mosrespektimi i përgjegjësisë të ngarkuara për operatorin e sistemit të depozitës dhe GNL-së, sipas parashikimeve të neneve 61 dhe 69, të Ligjit;
 - xvi. aplikimi i kushteve shtesë në kontratat që janë drejt përfundimit, në kundërshtim me nenin 76, pika 5, të Ligjit;
 - xvii. mosnjoftimi i klientëve nga furnizuesi i mundësisë së fundit, sipas kërkesave të nenit 90, pika 4, të Ligjit;
 - xviii. mosrespektimi i kërkesave të nenit 77, të Ligjit, në lidhje me ruajtjen e të dhënave;
 - xix. mosrespektimi i detyrimit për të lidhur kontratë, sipas nenit 96, pika 8, të Ligjit, për klientët që plotësojnë kushtet, sipas pikës 1, të këtij neni;
- b) ERE duke vepruar sipas Neneve 39(7) dhe 106(2) të Ligjit mund të vendosë masa administrative deri në 10% të të ardhurave vjetore të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit, ose mbi 10% të të ardhurave vjetore të kompanive vertikalisht të integruara, mbi kompanitë vertikalisht të integruara për mos-përputhjen me detyrimet e tyre respektive në lidhje me veçimin dhe/ose pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me Nenin 36 të Ligjit.
- c) ERE aplikon gjobë progresive për çdo ditë shkelje ndaj subjekteve të Ligjit, për rastet e mëposhtme:
- i) kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje, brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast, i licencuari dënohet me gjobë, në masën 0,1 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës,

- për çdo ditë vonese nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;
- ii) kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë, në masën 0,2 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.
2. Masat e gjobës do të përcaktohen nga ERE në përputhje me Aneksin 1, të kësaj Rregulloreje, brenda kufijve si më poshtë:
 - a. Jo më shumë se 0.5% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licensuarit.
 - b. Jo më pak se 0,1% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licensuarit.
 - c. Jo më shumë se 10% të të ardhurave vjetore nga viti financiar i kaluar, i operatorit të sistemit të transmetimit ose kompanitë vertikalisht të integruara
 3. Gjoha progresive për çdo dite vonesë, nuk mund të kalojë vetë vlerën e gjobës fillestare ose vlerën maksimale të përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni.
 4. Vlera përfundimtare e gjobës do të përcaktohet si zbritje e vlerës fillestare të gjobës me vlerën e kushteve lehtësuese nëse kjo e fundit mund të aplikohet.

Neni 6

Fillimi i hetimit

1. Procedurat e vendosjes dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për Kundërvajtjet Administrative". ERE mund të fillojë një hetim për vendosje gjobe, në rastet kur:
 - a. Ka marrë kryesisht dijeni për një shkelje;
 - b. Vihet në dijeni nga një i licensuar tjetër apo nga nje subjekt i interesuar për një shkelje.
 - c. Ka dyshimin e arsyeshëm se kushtet e licensës janë shkelur.
2. Në çdo rast fillimi i hetimit vendoset me urdhër të Kryetarit të ERE, apo vendim të Bordit të ERE.

Neni 7

Shqyrtimi fillestar

1. ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje gjobe, nëse shkelja e pretenduar apo konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 6 muaj që ka ndodhur.
2. Në çdo rast që stafi teknik i cili ka kryer hetimin, konstaton një nga shkeljet e parashikuara në nenin 5, do të përgatisë një informacion/relacion të detajuar mbi shkeljen/et e konstatuara dhe propozimin për fillimin e procedurës për vendosje gjobe ndaj të licensuarit.
3. Vendimi i Bordit të ERE-s për të filluar procedurën e vendosjes së gjobës një të licensuari, do t'i njoftohet të licensuarit nga ERE, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit të Bordit të ERE.
4. Njoftimi për vendosjen e gjobës do të përmbajë:
 - Shkeljen e konstatuar.
 - Masën e Gjobës së propozuar.
 - Identitetin e të licensuarit.

- Dokumentacionin provues ku mbështetet vendosja e gjobës.
 - Të drejtën e të licensuarit për të kthyer përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike, nga marrja dijëni, si dhe paraqitjen e argumentave dhe çdo dokumentacioni shkresor mbështetës në funksion të përgjigjes së tyre apo për qëllime të aplikimit të rrethanave lehtësuese. I licensuari ka të drejtë që brenda këtij afati, të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore për të bërë sqarimet e duhura.
5. Në çdo fazë të një procedimi për vendosje gjobe, ERE mund të kryejë seanca dëgjimore me të licensuarin dhe subjektin që ka kërkuar kryejën e hetimit, ose të kërkojë dokumenta të tjerë të nevojshëm për qëllime të procedurës së nisur. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Neni 8

Përcaktimi i vlerës fillestare të gjobës

ERE do të përcaktojë vlerën fillestare të gjobës brenda kufirit maksimal dhe minimal të vendosur në nenin 106, pika 1 të Ligjit. Rëndësia e shkeljes do përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a. rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
- b. nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht më parë;
- c. rëndësinë e kundërvajtjes;
- d. pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi;
- e. nëse kundërvajtësi është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje.

Neni 9

Rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës rrethanat e kryerjes së shkeljes do të konsiderohen të lehta, mesatare apo të rënda.
2. Për përcaktimin e niveleve të rrethanave do merren për bazë kriteret e mëposhtme:
 - a. Pozicioni hierarkik në kompani i personit që ka kryer shkeljen;
 - b. Mungesa e modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt me qëllim parandalimin e kryerjes së shkeljes;
 - c. Përpjekjet për të fshehur shkeljen.

Neni 10

I licensuari me precedentë dënimi administrativ

Nëse i licensuari është dënuar më parë për shkelje të legjislacionit të Sektorit të Energjisë, është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje administrative, gjoba përfundimtare e parashikuar për llojin e kundërvajtjes, do të rritet në masën 10 % të vlerës së gjobës minimale të kriterit përkatës të parashikuar në Aneksin 1.

Neni 11

Rëndësia e shkeljes së kryer

1. Për efekt të llogaritjes së rëndësisë së shkeljes së kryer, ato do të konsiderohen të rëndësisë së ulët, mesatare apo të lartë.
2. Për përcaktimin e nivelit të rëndësisë së shkeljes së kryer do të merret për bazë:
 - a. Përfitimi financiar i realizuar nga i licensuari i cili do të llogaritet mbi bazën e raportit të të ardhurave të përfituara me të ardhurat vjetore të vitit paraardhës të të licensuarit.
 - b. Dëmi i shkaktuar në palë të treta.

Neni 12

Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës, pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i të licensuarit do konsiderohen të nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.
2. Për përcaktimin e niveleve të pasojave do merren për bazë kriteret e mëposhtme:
 - a. Dëmi i shkaktuar apo rritja e kostove të shkaktuara konsumatorëve apo pjesëmarrësve në treg;
 - b. Numri i klientëve të përfshirë;
 - c. Rritja e dominancës në treg të të licensuarit;
 - d. Pengimi i punës së ERE në kryerjen e funksioneve të veta ligjore për monitomin dhe kontrollimin e të licensuarit.

Neni 13

Lehtësimi Nga Gjoha

1. ERE do të konsiderojë se i licensuari plotëson kushtet për lehtësimin në vlerën e gjobës, kur gjatë hetimit rezulton se ekzistojnë një ose të gjitha rrethanat si më poshtë:
 - a. në masën 50 %, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet gjoba, është njoftuar nga vetë i licensuari;
 - b. në masën 1/3, në rastet kur i licensuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë;
 - c. në masën 40 %, në rastet kur i licensuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE.
 - d. do të konsiderohen veprime që çojnë në përmirësimin e tregut, veprimet të cilat pavarësisht shkeljes kanë ndikuar në përmirësimin e standarteve të shërbimit, konkurrencës, eficensës në treg etj.

Neni 14

Propozimi Përfundimtar

1. Pasi ka marrë përgjigjen me shkrim nga i licensuari në përputhje me nenin 7 paragrafi 4 pika 5 dhe/ose sipas seancës dëgjimore në përputhje me nenin 7, paragrafi 5 i kësaj Rregullore, personat e autorizuar nga stafi i ERE-s, duhet të rishikojnë përgjigjen e të licensuarit dhe çdo dokument, informacion të mbledhur gjatë procedurës, jo më vonë se

5 ditë pune pas marrjes së përgjigjes së të licensuarit, ose sipas rastit, seancës së fundit dëgjimore.

2. Bordi i ERE mund të vendosë të mos gjobisë të licesuarin sipas propozimit të stafit teknik nëse konstaton se faktet e paraqitura nuk provojnë shkeljen.

Neni 15 **Vendimi I Bordit**

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licensuarit, Bordi i ERE do të vendosë për ndëshkimin ose jo të të licensuarit dhe vlerën përkatëse të gjobës.
2. Në përfundim të një procedure për vendosjen e gjobës një subjekti të licensuar, ERE do të njoftojë të licensuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij si dhe do ti dërgojë një kopje të Vendimit të Bordit, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.
3. Gjoha e vendosur nga Bordi i ERE përben titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 16 **Apelimi i vendimit**

Kundër Vendimit të Bordit të Komisionerëve për vendosje të gjobes, i licensuari mund të bëjë ankim në përputhje me Ligjin. Ankimi ndaj vendimit të ERE-s, për heqjen e licencës apo miratimit, për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje administrative, bëhet sipas Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për Kundërvajtjet Administrative”.

PJESA E TRETË **Dispozita të Fundit**

Neni 17 **Amendamente të rregullores**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 18 **Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore dhe pjesët përbërëse të saj, hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSI 1

Tabela për llogaritjen e vlerës përfundimtare të gjobës

Faza I; Fiksimi i vlerës fillestare të gjobës, në varësi të rëndësisë së shkëljes			
Kriteret e rëndësisë së shkëljes			
1. Kohëzgjatja e shkëljes dhe Shtrirja territoriale e saj	25 %	E shkurtër	2 %
		E mesme	6%
		E gjatë	12 %
		Lokale	2 %
		Rajonale	4 %
		Kombëtare	13 %
2. Ndikimi i shkëljes në funksionimin e tregut të energjisë	25 %	I ulët	4 %
		I mesëm	12 %
		I lartë	25 %
3. Perfitimi ekonomik i realizuar nga i licencuari si pasojë e shkëljes	25 %	I ulët	4 %
		Mesatar	12 %
		I lartë	25 %
4. Lloji i fajësisë së të licencuarit	25 %	Dashje	25 %
		Pakujdesia	8 %
Faza II: Llogaritja e gjobës përfundimtare do bëhet sipas formulës: Gj= VFGj-KL Ku GJ = Gjoha VFGJ = Vlera fillestare KL = Kushtet Lehtësuese			
Kushtet Lehtësuese	1. Shkelja për të cilën parashikohet gjobë deklarohet nga vetë i licensuari		50%
	2. I licensuari bashkëpunon në mënyrë efikase në procesin e investigimit të ERE për		33%

	shkeljen në fjalë	
	3. I licensuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja.	40%